



Prishtinë, 05 maj 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1733_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.11, Nenin 30 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 par. 1 nënpar. 1.11, Nenin 4, Nenin 7, Nenin 8 dhe Nenin 15 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 23 dhe Nenin 75 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare
- Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura, të datës 06 shtator 2022, respektivisht 07.02.2023 për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike, të bërë nga ndërmarrja Danske Commodities Kosovo SH.P.K., adresa: Qyteza Pejton, Rr.Mujo Ulqinaku, Nr.5, Ap.10, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

në seancën e mbajtur me datë 05 maj 2023, nxori këtë:

VENDIM

- I. VAZHDOHET Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike ndërmarrjes Danske Commodities Kosovo SH.P.K., me numër licence ZRRE/Li_39/17 për periudhën pesë (5) vjeçare, nga data 22 prill 2023 deri 21 prill 2028.**
- II. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për Danske Commodities Kosovo SH.P.K., të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.**

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (në vijim Rregullatori) me datë 06 shtator 2022 në formë elektronike dhe me 07.02.2023 përmes administratës së Rregullatorit (Nr.055/23) ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike nga përfaqësues të ndërmarrjes Danske Commodities Kosovo SH.P.K.



- Për licencim të këtij aktiviteti, Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi duke dërguar në Rregullator dëshmitë/kërkesat dhe të dhënat tjera të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim.
 - Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja **Danske Commodities Kosovo SH.P.K.**, me datë 01.02.2023 dhe 03.02.2023 ka njoftuar përmes gazetave palët e interesit se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtisë) me energji elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës.
 - Sipas Nenit 6 të Rregullës së sipërpërmendur, palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim të bërë nga palët e interesit, për këtë aplikacion.
 - Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
 - Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas udhëzimeve të rregullatorit, aplikacioni është konsideruar i kompletuar, kështu që Bordi i Rregullatorit duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
 - Danske Commodities Kosovo SH.P.K. është licencuar nga ZRRE nga 22.04.2013 deri 22.04.2018, dhe i është vazhduar licenca nga 22.04.2018 deri 21.04.2023.
 - Licenca e lëshuar me datë 22.04.2013 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_39/13), e modifikuar me datë 10.05.2017 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_39/17), e vazhduar nga 22.04.2018 deri 21.04.2023, do të vazhdojë të jetë e vlefshme edhe për një periudhë pesë (5) vjeçare, deri më **21 prill 2028**, dhe mund të vazhdohet, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës dhe plotëson kushtet për vazhdim licence, në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, si dhe me dispozitat përkatëse të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
- III. Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit **Danske Commodities Kosovo SH.P.K.**,
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


Bordi i Rregullatorit:



Ymer Fejzullahu, Kryesues



Lutfije Dervishi, Anëtare



Gani Buçaj, Anëtar